



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201502557/11

Tiranë ___/___/2016

Lënda: *Rekomandohet ndërhyrja e organit që ju përfaqësoni mbi veprimtarinë e ZQRPP, Tiranë, si dhe ZVRPP, Elbasan, për zgjidhjen e çështjes së shtetasit M.F.*

Drejtuar : **Ylli Manjani**
Ministër i Drejtësisë

TIRANE

I nderuar Z.Manjani!

Në cilësinë e përfaqësuesit të Ministrisë së Drejtësisë e cila administron veprimtarinë e regjistrimit publik për pasuritë e paluajtshme, sikurse parashikuar në nenin 198 të Kodit Civil, në të cilin parashikohet se;

"Ministria e Drejtësisë administron veprimtarinë e regjistrimit publik për pasuritë e paluajtshme", organit epror për Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (neni 9 i ligjit nr.33/2012), sjell në vëmendjen tuaj çështjen si më poshtë prezantuar ;

Institucioni që unë përfaqësoj, në ushtrimin e detyrës për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, pengohet në ushtrimin e kësaj detyre prej individëve, përfaqësues të organeve në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

Në mënyrë të parregullt, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Elbasan, apo Kryeregjistruesi i ZQRPP, kanë shkelur dhe shkelin të drejtën e pronësisë së ankuesit, shtetasit M.F., në kushtet e mosrespektimit të detyrimit ligjor për regjistrimin e Titullit të Pronësisë, Vendimit nr.11, datë 25.10.1993, të KKKP, pranë Këshillit të Rrethit, Elbasan, sikurse parashikuar në nenin 196 të K. Civil, neni 38/3, 41/1 të Ligjit Nr.33/2012, *"Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme"*, të ndryshuar.

Pa shkak të ligjshëm, ZVRPP, Elbasan, Kryeregjistruesi i ZQRPP, refuzojnë regjistrimin e titullit të mësipërm të pronësisë si dhe lëshimin e dokumenteve të pronësisë në favor të subjektit pronar.

Në ushtrim të detyrës për mbrojtjen e të drejtave lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, Institucioni i

Avokatit të Popullit ka rekomanduar me shkresën nr. K3/M67-2 Prot, datë 18.08.2016, Regjistruesit të ZVRPP, Elbasan :

“Kryerjen e veprimeve për regjistrimin e Titullit të Pronësisë, Vendimit nr.11, datë 25.10.1993, të dhënë prej Ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, Këshilli i Rrethit, Elbasan, si dhe lëshimi i dokumenteve të pronësisë për pasurinë truall me sipërfaqe 12200m2 e njohur në pronësi pronarëve S dhe M.F.”.

Në përgjigje të rekomandimit të dhënë, Regjistruesi i ZVRPP, Elbasan, me shkresën nr.1039/1 prot, datë 24.08.2016, shpreh qëndrim refuzues për përmbushjen e detyrimeve ligjore të rrjedhura, me rastin e paraqitjes së Titullit të Pronësisë, Vendimit nr.11, datë 25.10.1993, të KKKP, Këshilli i Rrethit, Elbasan, për regjistrim. Qëndrimin e shprehur prej Regjistruesit të ZVRPP, Elbasan, në rastin më të mirë, është tregues i moskuptimit të së drejtës së pronësisë sikurse përcaktuar në të Drejtën Civile apo parashikuar në Kodin Civil.

Ndodhur në këto kushte, referuar parashikimeve të nenit 23 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, është rekomanduar me shkresën nr. K3/M67-9 Prot, datë 22.11.2016, Kryeregjistruesit të ZQRPP, Tiranë,

“Ushtrimin i kompetencave për sigurimin e mire funksionimit, zbatimit të legjislacionit, prej ZVRPP, Elbasan, në çështjen e shtetasit M.F.”.

Kryeregjistruesi i ZQRPP, edhe pse ka marrë dijeni zyrtare për rekomandimin e dhënë, shpreh të njëjtin qëndrim sikurse Regjistruesi i ZVRPP, Elbasan, lidhur me çështjen objekt prezantimi, në shkresën nr.5645/4 Prot, datë 01.12.2016, drejtuar ankuesit M.F. Kjo situatë, për çështjen në fjalë, ju është prezantuar prej Institucionit të Avokatit të Popullit në shkresat nr.K3/I51-2 Prot, datë 18.10.2016, K3/H3-12 Prot, datë 20.09.2016 dhe K3/M67-2 Prot, datë 18.08.2016.

Përkundër kësaj situatë, si më sipër prezantuar, gjykojmë se, qëndrimi i Regjistruesit të ZVRPP, Elbasan, Kryeregjistruesit të ZQRPP, Tiranë, është tregues i shkeljes së parimit të ligjshmërisë, transparencës, informimit, dhënies së ndihmës aktive, drejtësisë dhe paanësisë, përgjegjësisë, deburokratizimit dhe efijencës, sikurse parashikuar në nenet 4, 5, 6, 10, 13, 14, 15, dhe 18, të ligjit nr.44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, të detyrueshme për zbatim në kuptim të parashikimeve të kryera në nenin 1 të këtij Kodi.

Gjithashtu, situatën e krijuar në procesin e trajtimit të kësaj çështjeje e vlerësojmë jo në përputhje me parimin për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, sikurse garantuar nga sanksionimi i kryer në nenin 42/2 të Kushtetutës apo nenin 6/1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.07.1996 *“Pë ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”*.

Për arsyet e bëra të ditura, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, në të cilin sanksionohet se; *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata Publike”*, si dhe nenit 22 dhe 23 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar,

REKOMANDOJMË

Ndërhyrjen e organit që ju përfaqësoni mbi veprimtarinë e ZQRPP, Tiranë, si dhe ZVRPP, Elbasan, për zgjidhjen e çështjes së drejtë të shtetasit M.F.

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit, konform parashikimit të kryer në nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, kthimi i përgjigjes do të duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Bashkëlidhur ju dërgojmë;

Kopje të shkresës nr. K3/I51-2 Prot, datë 18.10.2016, të Avokatit të Popullit, drejtuar Ministrit të Drejtësisë.

Kopje të shkresës nr. K3/H3-12 Prot, datë 20.09.2016, të Avokatit të Popullit, drejtuar Ministrit të Drejtësisë dhe Kryeregjistruesit të ZQRPP, Tiranë.

Kopje të shkresës nr. K3/M67-2 Prot, datë 18.08.2016, të Avokatit të Popullit, drejtuar Regjistruarit të ZVRPP, Elbasan.

Kopje të shkresës nr. 1039/1 Prot, datë 24.08.2016, të ZVRPP, Elbasan, drejtuar Avokatit të Popullit.

Kopje të shkresës nr. 911/1 Prot, datë 12.07.2016, të ZVRPP, Elbasan, drejtuar Avokatit të Popullit.

Kopje të shkresës nr. 1748 Prot, datë 13.06.2014, të ZVRPP, Elbasan, drejtuar Avokatit të Popullit.

Kërkesë, aplikim nr. 5193, datë 05.06.2014, i kryer prej ankuesit pranë ZVRPP, Elbasan.

Kopje të shkresës nr. 1256/1 Prot, datë 02.05.2014, të AKKP drejtuar ankuesit Muharrem Ferra.

Kopje të Vendimit nr.11, datë 25.10.1993, i KKKP, pranë Këshillit të Rrethit, Elbasan.

Kopje të shkresës nr. 1899/1 Prot, datë 24.04.2014, Ministrisë së Drejtësisë drejtuar AKKP.

Kopje të Vërtetimit nr.72, datë 18.04.1995, lëshuar prej Këshillit të Rrethit Elbsan, Seksioni i Kadastrës.

Kopje të shkresës nr. 2942/1 Prot, datë 29.07.2008, të AQSH së bashku me listen e pronarëve regjistruar me nr.F.486, pa vit, D1276, J 32.

Kopje të shkresës nr. K3/H3-9 Prot, datë 22.11.2016, të Avokatit të Popullit, drejtuar Kryeregjistruesit të ZQRPP, Tiranë.

Kopje të shkresës Nr.5645/4 Prot, datë 01.12.2016, të ZQRPP, Tiranë, drejtuar ankuesit M.F.

Kopje të shkresës nr.5645/1 Prot, datë 02.08.2016, të ZQRPP, Tiranë, drejtuar ZVRPP, Elbasan.

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

